



BISHZ - VAIS - UIAS - UIAS

BASHKIMI I INTELEKTUALËVE SHQIPTARË NË ZVICËR
VEREINIGUNG DER ALBANISCHEN INTELLEKTUELLEN IN DER SCHWEIZ
UNION DES INTELLECTUELS ALBANAIS EN SUISSE
UNIONE INTELLETTUALI ALBANESI IN SVIZZERA

Statuti

BISHZ - VAIS - UIAS

12.01.2002

Versioni 2.0

Id. i dokumentit::	E:\BISHZ\SEKRETARIATI\ Statuti-BISHZ-2002-SHQ.doc
Klasifikimi:	Vetëm për shfrytëzim të brendëshëm
Data	10.01.2002
Emri i fajllit:	<u>Statuti-BISHZ-2002-SHQ.doc</u>
Version:	V2.0
Krijuesi:	<u>Dr. sc. Ahmet Xhigoli</u>
Firma:	Bashkimi i intelektualëve shqiptarë në Zvicër (BISHZ)
Përgatitja e fundit:	12.01.2002
U shpërndahet:	BISHZ

STATUTI

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

- 1.1. Emri i Shoqatës është: „BASHKIMI I INTELKTUALËVE SHQIPTARË NË ZVICËR“ – në tekstin e mëtejme Shoqata.
- 1.2. Shoqata është bashkim i lirë dhe i pavarur i intelektualëve shqiptarë në Zvicër.
- 1.3. Shoqata nuk ushtron veprimtari fitimprurëse dhe vepron në përputhje me nenin 60 të Kodit Civil Zviceran.
- 1.4. Selia e Shoqatës është në Bernë.

Neni 2

- 2.1. Simboli i shoqatës është – shih shtojcën.
- 2.2. Vula e Shoqatës ka formën e rrumbullakët dhe mban mbishkrimin: BASHKIMI I INTELKTUALËVE SHQIPTARË NË ZVICËR, në katër gjuhë: shqipe, gjermane, frënge dhe italishte.

II. QËLLIMI DHE FORMAT E VEPRIMTARISË SË SHOQATËS

Neni 3

- 3.1. Shoqata krijohet dhe vepron duke patur si qëllim themelor të bashkojë potencialin intelektual shqiptar në Zvicër dhe atë ta vëjë në shërbim të çështjes kombëtare në përgjithësi dhe të bashkësisë shqiptare në Zvicër.
 - a) Këto synime ajo i sendërton nëpërmjet organizimit dhe zhvillimit të **veprimtarive kulturore, projekteve profesionale e shkencore dhe tribunave të ndryshme.**
 - b) Për të realizuar programin e saj, Shoqata është e hapur dhe bashkëpunon me përfaqësuesit e ligjshëm të Republikës së Kosovës, të Republikës së Shqipërisë, të shqiptarëve në trevat etnike, me përfaqësuesit e Qeverisë Zvicerane si dhe me subjektet e organizuara shqiptare në Zvicër, entet dhe shoqatat profesionale simotra.

III. ANËTARËSIMI DHE HUMBJA E ANËTARËSISË

Neni 4

- 4.1. Anëtar i BISHZ-së mund të jetë çdo intelektual-e që pranon statutin, paguan kuotizacionin e anëtarësisë dhe kontribuon në mbarëvajtjen e punës së Shoqatës.
- 4.2. Pranimi i anëtarëve bëhet në bazë të kërkesës vetjake, në mbështetje të statudit dhe bëhet i vlefshëm e përfundimtar pas miratimit të tij në Kuvendin më të afërt të shoqatës.
- 4.3. Kuvendi mund të shpallë anëtarë nderi personat që kanë merita të posaçme për mbarëvajtjen e punës, apo ata që me anëtarësimin e tyre i bëjnë nder shoqatës.
- 4.4. Shuarja e anëtarësisë bëhet:

- a) me vdjekjen e anëtarit.
- b) me dëshirën për t'u larguar prej Shoqatës, të shprehur me shkrim një muaj para përfundimit të vitit financiar.
- c) nëse deri më 30 qershor të çdo viti, anëtari nuk ka paguar kuotizacionin vjetor.
- d) me pezullimin e anëtarit me vendim të kryesisë.

4.5. Anëtari i pezulluar me vendim të kryesisë ka të drejtën që brenda 30 ditëve të paraqesë ankesën me shkrim ndaj vendimit të kryesisë. Përrjashtimi merr formë të prerë vetëm pasi të jetë shqyrtuar dhe miratuar me shumicë votash nga Kuvendi i Shoqatës.

IV. TË DREJTAT DHE DETYRAT E ANËTARËVE TË SHOQATËS

Neni 5

5.1. Anëtari i Shoqatës ka të drejtën:

- a) të marrë pjesë në seancat e rregullta dhe të jashtëzakonshme të Kuvendit të Shoqatës.
- b) të shprehë lirisht mendimin rreth çështjeve përkatëse në kuadrin e Programit dhe të Statutit të Shoqatës.
- c) të zgjedhë dhe të zgjidhet në organet e Shoqatës.
- d) të jetë bartës i veprimtarive të Shoqatës.

5.2. Përgjegjësia e anëtarëve:

Anëtarët e shoqatës duhet të respektojnë kodeksin e Shoqatës, në të kundërtën i nënshtrohen procedurës për përjashtim nga Shoqata.

- a) Anëtari i cili me deklaratat dhe sjelljet e tij e pengon mbarëvajtjen e punës së Shoqatës, i nënshtrohet përgjegjësisë disiplinore para Kryesisë e cila, në rast nevojë, bën pezullimin e tij në bazë të nenit 4.4. pika d. të Statutit të Shoqatës.

V. ORGANET E SHOQATËS

Neni 6

6.1. Organet e Shoqatës janë:

- a) Kuvendi i Shoqatës
- b) Kryesia
- c) Sekretariati
- d) Komisioni statutar
- e) Komisioni i kontroll-revizionit dhe
- f) Komisione të tjera të zgjedhura nga Kuvendi i Shoqatës.

6.2. Organet e Shoqatës (nga pika b. deri në f.), për punën e tyre i përgjigjen Kuvendit të Shoqatës.

VI. KUVENDI I SHOQATËS

Neni 7

7.1. Kuvendi i Shoqatës është organi më i lartë i BISHZ-së. Ai përbëhet nga të gjithë anëtarët.

Të drejtat e patjetërsueshme të Kuvendit të Shoqatës janë:

- a) miratimi ose ndryshimi i statutit.
- b) vendimi mbi pranimin e anëtarëve të rinj dhe përjashtimin eventual, si dhe shqyrtimin dhe marrjen e vendimit lidhur me ankesat e paraqitura në Kuvend.

- c) zgjedhja e kryetarit dhe këshilltarëve me mandat dyvjeçar.
 - d) zgjedhja e komisionit të kontroll-revizionit.
 - e) miratimi i veprimtarisë financiare, buxhetit vjetor, raportit vjetor të komisionit të kontroll-revizionit dhe i programit vjetor të punës.
 - f) shkarkimi i kryesisë dhe komisionit të kontroll-revizionit.
 - g) caktimi i kuotizacionit vjetor të anëtarësisë.
 - h) marrja e vendimeve për çështje që nuk përfshihen në kompetencat dhe të drejtat e organeve të tjera të BISHZ-së.
- 7.2. Kuvendin e Shoqatës e drejton kryetari i kryesisë ose në mungesë të tij, nënkryetari i saj. Për raste të veçanta, Kuvendi mund të caktojë drejtuesin e vet enkas për mbledhjen përkatëse.
- 7.3. Kuvendi i rregullt i Shoqatës mbahet çdo vit, jo më vonë se gjashtë muaj pas përfundimit të vitit financiar. Kuvendi i jashtëzakonshëm i shoqatës mund të thirret në rast se 1/3 e anëtarëve i paraqesin kryesisë kërkesën e argumentuar me shkrim.
- 7.4. Lajmërimi për Kuvendin e zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm të shoqatës bëhet me lajmërim-ftesë të rregullt të anëtarëve që përmban rendin e ditës dhe që shpërndahet së paku 10 ditë para ditës së mbajtjes së Kuvendit.
- 7.5. Nuk mund të merren vendime nëse në Kuvend numri i anëtarëve nuk kapërcen 2/3 e numrit të përgjithshëm të tyre. Vendimet merren nëse shumica absolute e pjesëmarrësve shprehet pozitivisht për to. Në rast se pas votimit të parë nuk arrihet shumica absolute, atëherë bëhet votimi i dytë jo më parë se gjysmë ore nga përfundimi i votimit të parë. Në votimin e dytë vendimet merren me shumicë relative.
- 7.6. Vendimet e zakonshme të Kuvendit merren pasi për to ka votuar shumica absolute e pjesëmarrësve. Ndërsa vendimet për ndryshimin e statutit dhe për shpërndarjen e Shoqatës duhet të merren me 2/3 e votave të anëtarëve të pranishëm.
- 7.7. Kuvendi i Shoqatës nuk mund të vendosë për çështje, të cilat nuk janë përfshirë në rendin e ditës, me përjashtim të rasteve kur bëhet propozim për thirrjen e Kuvendit të jashtëzakonshëm të Shoqatës.
- 7.8. Zgjedhja dhe emërimi i të gjitha organeve të Shoqatës bëhet me vota të fshehta.

Neni 8

KRYESIA

- 8.1. Kryesia përbëhet nga kryetari, nënkryetari, sekretari, arkëtari dhe të paktën pesë këshilltarë .
- 8.2. Kryesia, në mbledhjen e saj të parë emëron kryetarin, nënkryetarin, sekretarin, arkëtarin dhe cakton detyrat për secilin anëtar.
- 8.3. Kryesia zgjidhet me mandat dyvjeçar. Anëtarët e zgjedhur në kryesi kanë të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë. Në rast vdekjeje ose dorëheqjeje të anëtarit të Kryesisë, zgjidhet anëtar i ri nga Kryesia.
- 8.4. Mbledhjen e kryesisë kanë të drejtë ta thërrasin kryetari ose të paktën tre anëtarë të saj.
- 8.5. Vendimet e kryesisë janë të vlefshme vetëm kur është e pranishme shumica e anëtarëve të saj me të drejtë vote.
- 8.6. Kryesia ka për detyrë të drejtojë dhe mirëadministrojë BISHZ-në, për përmbushjen e detyrave që burojnë nga statuti dhe programi i saj. Ajo vendos për rrugët dhe mjetet e realizimit të synimeve të Shoqatës.
- 8.7. Kryesia ka për detyrë të hartojë projektin e plan-buxhetit dhe bilancin vjetor. Ajo cakton rregulloren e brendëshme të Shoqatës në përputhje me statutin e Shoqatës.
- 8.8. Anëtarëve të kryesisë u ndalohe, që në emër të Shoqatës të hyjnë në marrëdhënie për interesa vetjake.

- 8.9. Për veprimet financiare në emër të BISHZ-it, personat e autorizuar për të nënshkruar me të drejtë kolektive janë arkëtari dhe dy anëtarë të kryesisë.

Neni 9

SEKRETARIATI

- 9.1. Në sekretariat bëjnë pjesë: kryetari, nënkryetari dhe sekretari.
- 9.2. Sekretari kryen në emër të kryesisë të gjitha detyrat korrente siç janë korrespondenca, lajmërimet për mbledhje, mbajtja e protokollit dhe çdo detyrë tjetër që ia beson kryesia.

Neni 10

KOMISIONI STATUTAR

- 10.1. Komisioni statutar analizon dhe kontrollon zbatimin e Statutit të Shoqatës dhe shqyrton ankesat lidhur me shkeljet statutare.

Neni 11

KOMISIONI I KONTROLL - REVIZIONIT

- 11.1. Kuvendi i përgjithshëm vjetor cakton komisionin e kontroll-revizionit që përbëhet prej 3 anëtarëve, të cilët i zgjedh Kuvendi.

Neni 12

MJETET FINANCIARE

- 12.1. Burimet financiare janë:
- kuotizacionet e anëtarëve.
 - dhuratat dhe trashëgimet nga personat fizikë e juridikë të destinuara për mbarëvajtjen e punës së Shoqatës.
 - interesat e depozitave bankare.
 - të ardhurat që sigurohen nga shfaqjet, administrimi i lokaleve për takime, veprimtaritë sportive e të tjera.
- 12.2. Masa e kuotizacioneve të anëtarëve caktohet nga kryesia. Ato duhet të derdhen në xhironlogarinë e Shoqatës.
- 12.3. Kuotizacionet paguhen në këste deri më 30 qershor.
- 12.4. Në mbyllje të bilancit financiar vjetor, Kuvendi i Shoqatës vendos për mënyrën e përdorimit të mjeteve dhe destinimin e tyre.

Neni 13

FORMAT E KOMUNIKIMIT

- 13.1. BISHZ-ja vepron në tërë territorin e Zvicrës dhe ka vetëm organet e sipërpërmendura (pa degë dhe nëndegë). Anëtarët dhe bashkëpunëtorët e Shoqatës, përveç kontakteve të drejtëpërdrejta, komunikojnë me Kryesinë edhe nëpërmjet telefonit, faksit, postës elektronike, etj.

13.2. BISHZ-ja nxjerr fletushkën e vet, ku pasqyron veprimtarinë e saj.

Neni 14

SHUARJA E SHOQATËS

- 14.1. Shuarja e veprimtarisë së Shoqatës bëhet me vendim të Kuvendit ose në rastin kur nga Shoqata largohen 90% e anëtarëve. Kuvendi që vendos për këtë, cakton një këshill prej tre anëtarësh i cili ka për detyrë të kryejë veprimet përmbyllëse të shuarjes së Shoqatës.
- 14.2. Nëse pas shuarjes gjendja financiare ka saldo aktive, atëherë shuma e saldოს kalon në pronësi të ndonjë organizate humanitare ose fondacioni.

Neni 15

INTERPRETIMI

- 15.1. Vetëm teksti *shqip* i këtij statuti ka vlerën e tekstit origjinal.

Neni 16

DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

- 16.1. Ky statut është miratuar nga Kuvendi i katërt i rregullt i Shoqatës, në Langenthal, në datën 12 janar 2002 dhe hyn në fuqi menjëherë.
- 16.2. Një kopje i këtij statuti i dorëzohet Ambasadës së Republikës së Shqipërisë në Bernë, Misionit të Republikës së Shqipërisë pranë Zyrës së Kombeve të Bashkuara në Gjenevë, Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Republikës së Kosovës në Prishtinë, Akademisë së Shkencave të Republikës së Shqipërisë në Tiranë, Rektoratit të Universitetit të Prishtinës, Rektoratit të Universitetit të Tiranës dhe Rektoratit të Universitetit të Tetovës.

Bern, 12 janar 2002

Kryetari: Dr. Xhevat Saljihi Nënkryetari: Dipl. Ing. Sinollah Shehu Sekretari: Dr. sc. Ahmet Xhigoli

Shtojcë: Simboli i shoqatës

